



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01. Nr. 16-24227/16
Kaçanik, 26.07.2016

Në bazë të nenit 12, 14, 17 lidhur me nenin 18.1(a) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2.4 dhe 3.6 të Ligjit 03/L-139 -Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit 03/L-139 - Për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 91), të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-159 - Për Zonat Ekonomike, (Gazeta Zyrtare Nr. 6/2012 e datës 13 mars 2013) të nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me, 26 Korrik 2016, mori këtë :

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK TË
PATUNDHMËRISË SË DISA PARCELAVE KADASTRALE NË ZONAT
KADASTRALE; SOPONICË, STAGOVË DHE KOXHAJ

1. Me këtë Vendim, Shpallet me interes të përgjithshëm publik –për interesa ë Komunës së Kaçanikut, patundshmëria në parcelat kadastrale nr.00003-0, 00004-1,00064-2,00065-0,00066-0,00067-0,00068-0,00070-0,00071-0,00072-0,00073-0,00074-0,00075-0,00076-0,00077-0,00078-0,00079-0,00080-0,00081-0,00082-0,00083-0,00084-0,00085-0,00086-0,00087-0,00088-0,00089-0,00090-0,00091-0,00092-0,00093-0,00094-0,00095-1,00096-0,00097-2,00098-2,00099-0,00100-0,00101-0,00102-0,00103-0,00104-0,00105-0,00106-0,00107-0,00108-0,00109-0,00110-0,00111-0,00112-0,00113-0,00114-0,00115-0,00116-0,00117-0,00118-0,00119-0,00120-0,00121-0,00123-0,00124-0,00125-0,00126-0,00127-0,00128-0,00130-0,00131-0,00139-0,00140-0,00141-0,00142-0,00143-0,00144-0,00145-0,00146-0,00147-0,00148-0,00149-0,00150-0,00151-0,00152-0,00153-0,00154-0,00155-0,00156-0,00157-0,00158-0,00159-0,00160-0,00161-0,00162-0,00163-0,00164-0,00165-0,00166-0,00167-0,00168-0,00169-0,00170-0,00171-0,00172-0,00175-2,00180-2,00181-1,00182-2,00183-1,00184-1,00185-0,00186-0,00187-0,00188-0,00189-0,00190-0,00191-0,00192-0,00193-0,00194-0,00195-0,00196-0,00197-0,00198-0,00199-0,00200-0,00201-0,00202-0,00203-0,00204-1,00205-1,00206-0,00207-0,00208-0,00209-0,00210-1 dhe 00211-2,Z.K Soponicë në emër të P.Sh Kooperativa Bujqësore Shtërpcë ,parcelat kadastrale nr. 01290-0,01291-0,01295-0,01296-0,01297-0 dhe 01298-0, në emër të P.Sh. Kooperativa Shtërpcë ,Z.K Stagovë dhe parcela kadastrale nr.00001-4. në emër të P.Sh. Kooperativa Shtërpcë,Z.K Koxhaj.
2. Parcelat Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, destinohet për interesin e Komunës Kaçanik- për Krijimin e Zonave Ekonomike.

3. Krijimi i Zonave Ekonomike në Kaçanik është në interesin e përgjithshëm publik, dhe lidhur më parcelat me numrat të sipërshtuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, mund të filloj procedura e Shpronësimit, dhe në asnjë mënyrë këto prona nuk mund të tjetërsohen dhe as t'i ndërrohet destinimi, pa Vendimin e Kuvendit të Komunës Kaçanik.
4. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas dispozitave ligjore të ligjeve në fuqi, t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik, i është drejtuar Kuvendit të Komunës Kaçanik me Propozim Vendim 01.Nr. 16-24227/2016 prej datës 20.07.2016-Për shpalljen e interesit të përgjithshëm të patundshmërisë së disa parcelave kadastrale në Z.K. në Soponicë, Stagovë, dhe Koxhaj, me interes të përgjithshëm publik - Për Krijimin e Zonave Ekonomike.

Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 26.07.2016, shqyrtoj Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës me numër të sipërshtuar dhe duke u bazuar në Arsyetimin e Shërbimit Profesional - Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim se; themelimin i Zonës Ekonomike është e një rëndësie të veçantë publike, ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve duke ju ofruar investitorëve infrastrukturë dhe hapsirë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste, nxitjen e investimeve private në veprimtarive prodhuese, hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave, zgjerimin e bashkëpunimit në mes të bizneseve, përshpejtimin e zhvillimit e rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut Kosovar dhe atij ndërkombëtar, pastaj arsyetimin e drejtorisë së, Ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit është aset me vlerë të veçantë, sepse gjendet udhëkryqi kryesor ku lidhen Shkupi, Tetova, Brezovica dhe Gjilani dhe se pronat e paluajtshme janë afër këtij udhëkryqi dhe me infrastrukturë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

